



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	04.08.2017
Referencë:	
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Nga:	Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së
Lënda:	Raporti i muajit Korrik 2017

Në bazë të përgjegjësisë dhe kompetencave gjatë muajit Korrik 2017, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin Qershor				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
41	22		1	18

- Janë dhënë Vendime, përgjigje, pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” Sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit.
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera në qytetin e Lipjanit.
- 14 Kërkesa DBF për zotim të mjeteve.
- 7 Kërkesa Drejtorisë së Prokurimit për inicim të procedurave të prokurimit për projektet të cilat janë në prioritet.
- Janë dhënë vendime për shfrytëzim të hapësirës publike.
- Janë përgatitë paramasa dhe paralogari.
- Janë dhënë pëlqime për: kyçje në rrugë, Bechtel Enka-së për asfaltim të rrugëve të fshatit Konjuh dhe Babush i Muhaxherëve.
- Pjesëmarrja në vlerësim të ofertave tenderuese në Drejtoratin për Prokurim.
- Intervenim në zhbllokim të rrjeteve të kanalizimit.
- Asistimi në hartimin e projekteve detale.
- Mbikëqyrjet e punimeve të projekteve:
- Ndërtimi i sheshit Adem Jashari.
- Hapja dhe pastrimi i lumenjve (Smallushë, Lipjan (Janjevka), Bujari, Akllap, Dobrajë, Blinajë), punimet kanë përfunduar, është bërë pranimi teknik.
- Ndërtimi i rrethojës së shkollave në Kraishtë dhe Bainsë punimet janë duke vazhduar.

- Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në disa fshatra: - kolektori në Lipjan punimet po vazhdojnë,
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gadime e Ulët, punimet janë duke vazhduar,
- Mbikëqyrja e punimeve “Ndërtimi i fushave sportive” – bashkëfinancim me Demos.
- Ndërtimi i fushave të vogla sportive në disa fshatra të komunës së Lipjanit.
- Asfaltimi i rrugës në Bainsë punimet kanë përfunduar, është bërë pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugës në Torinë – Poturovc, punimet kanë përfunduar, është bërë asfaltimi, pritet pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugës Shalë, punimet janë duke vazhduar.
- Asfaltimi i rrugës në Resinovec, është bërë asfaltimi, pritet pranimi teknik.
- Ndërtimi i trotuareve me ndriçim në Konjuh është bërë, pranimi teknike.
- Ndërtimi i trotuareve me ndriçim në Smallushë punimet janë duke vazhduar.
- Ndërtimi i trotuareve në fshatin Llugaxhi, është bërë pranimi teknike.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Hallaq i Madh, punimet kanë përfunduar, pritet pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Rubovec, punimet janë duke vazhduar.
- Hapja dhe zhavorrimi i rrugës në mes dy rrugëve regjionale punimet kanë përfunduar, është bërë pranimi teknik.
- Asfaltimi i rrugëve në fshatin Smallushë, punimet janë në përfundim e sipër.
- Puna me palë.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	29
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	9
3	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	4
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
	Takime zyrtare në Ministrinë e Infrastrukturës	2
7	Vizita në terren	68
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	1
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	4
10	Pranime teknike të projekteve të përfunduara	6